VENDIM
Nr. 61, datë 6.8.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "MBI RAPORTIMET NË BANKËN E SHQIPËRISË SIPAS SISTEMIT RAPORTUES TË UNIFIKUAR"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe të nenit 43, shkronja "c", të nenit 27, nenit 58, nenit 70, pika 1 dhe të nenit 71 të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 47, pika 4 dhe nenit 126, pikat 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neneve 42 dhe 50, të ligjit nr. 8782, datë 3.5.2001, "Për shoqëritë e kursim-kreditit", i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 10.6.2009, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

"a) Në formularët vjetorë të raportimit, pas formularit 6 shtohet formulari 6/1 me përmbajtjen sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi."

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko

INFORMACION MBI STRUKTURËN E AKSIONERËVE NË KAPITALIN E BANKËS RAPORTUESE

Formulari 6/1

Më datë: ..... 20 .....

EMRI I BANKËS .....

Emri dhe mbiemri i individit, personit fizik, emri tregtar i personit juridik, që ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë 1* në kapitalin e bankës raportuese	Përqindja e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë që zotëron në bankën raportuese.	Përqindja e të drejtave të votës që zotëron në bankën raportuese.	Datëlindja e individit, Numri i identifikimit. Data e themelimit të personit fizik, personit juridik 2*.	Adresa e përhershme e banimit të individit. Adresa e regjistruar e personit fizik, personit juridik 3*.	Shtetësia e individit, Vendi i regjistrimit të personit fizik, personit juridik.	Emri dhe mbiemri i individit, personit fizik, emri tregtar i personit juridik, që ka pjesëmarrje 4* të tërthortë në kapitalin e bankës raportuese në një vlerë jo më të vogël se 5 përqind.	Përqindja e pjesëmarrjes së tërthortë që zotëron në bankën raportuese.	Datëlindja e individit, Numri i identifikimit. Data e themelimit të personit fizik, personit juridik 2*.	Adresa e përhershme e banimit të individit. Adresa e regjistruar e personit fizik, personit juridik 3*.	Shtetësia e individit, Vendi i regjistrimit të personit fizik, personit juridik.
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11

[1] Informacioni i dhënë në kolonat 1 deri 6 lidhet me aksionerët që kanë pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në kapitalin e bankës raportuese (sipas Formularit 6 të SKU).

[2] Personat fizik dhe personat juridik që kanë selinë e regjistrimit në Republikën e Shqipërisë duhet të vendosin edhe numrin e NUIS, personat fizik dhe personat juridik të huaj duhet të vendosin datën e themelimit dhe numrin e identifikimit të organeve tatimore/regjistrit tregtar (sipas dëftesë e splikuesëmisë) sipas legjislacionit të vendit të tyre.

[3] Adresa e përhershme e banimit të individit, adresa e regjistruar e personit fizik dhe personit juridik duhet të jepet në formatin si vijon: rruga, numri, kodi postar (sipas dëftesë i splikuesëmisë), qyteti, shteti.

[4] Informacioni i dhënë në kolonat 7 deri 11 lidhet me aksionerët që kanë pjesëmarrje të tërthortë në kapitalin e bankës raportuese në një vlerë jo më të vogël se 5 përqind.

Shënim : 1. "Aksioner i drejtpërdrejtë i bankës" dhe "Aksioner i tërthortë i bankës" kanë të njëjtin kuptimin sipas Ligjit "Për bankat", Neni 4, ndarja I, respektivisht pika 29 dhe 30 e tij.
Shënim : 2. Ky formular raportohet çdo vit dhe sa herë ka ndryshime në aksionerët me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në kapitalin e bankës raportuese në një vlerë jo më të vogël se 5 përqind.
Shënim : 3. Vazhdon në rreshta të tjerë, në qoftë se është e nevojshme.

Përgatitur nga : _____ **Nënshkrimi** _____